



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.11

18 shkurt

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 222
datë 4.2.2010

Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së
Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë
“Eurocopter” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm
shumërolësh..... 353

LIGJ
Nr.10 222, datë 4.2.2010

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “EUROCOPTER”
PËR FURNIZIMIN ME 5 HELIKOPTERË TË MESËM SHUMËROLËSH**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet kontrata e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Eurocopter” për furnizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Programi i zbatimit të kontratës shtrihet në 4 vite buxhetore dhe përfundon në vitin 2013. Ministria e Mbrojtjes të marrë masat për planifikimin e fondeve përkatëse për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Neni 3

Ministria e Mbrojtjes të përzgjedhë dhe të negociojë me bankën e pranuar edhe nga shoqëria “Eurocopter” për mënyrat e kryerjes së pagesave me anë të letërkreditit.

Neni 4

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe nga kontrata.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6423, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONTRATË
NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
EUROCOPTER PËR FURNIZIMIN ME PESË (5) HELIKOPTERË AS532 AL COUGAR DHE
PAJISJET SHOQËRUESE

Nr. 12 / 2009
17.2.2009

PARATHËNIE

Kjo kontratë mban datën 17 dhjetor 2009,
ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri
e-mail: dmpm@mod.gov
telefon: ++355 4 225 5232
faks: ++355 4 225 5226

të përfaqësuar sipas rregullit nga: Shkëlqesia e Tij, Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë –
Autoriteti Kontraktues – (më poshtë referuar si “Blerësi”)

dhe

EUROCOPTER S.A.S me zyrë qendrore në: Aeroporti Ndërkombëtar i Marsejës – Provence
13725 MARIGNANE CEDEX – FRANCE

të përfaqësuar sipas rregullit nga: z.Thomas Hein, zëvendëspresident i Eurocopter – Kontraktuesi –
(më poshtë referuar si “Shitësi”),

Shitësi dhe Blerësi referuar gjithashtu si “Pala” ose “Palët”, nëpërmjet së cilës të dyja palët bien
dakord si vijon:

A. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj kontrate (përfshirë shtojcat), termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e
përcaktuara me hollësi në këtë seksion:

1.1 “Kontratë” nënkupton këtë kontratë midis Blerësit dhe Shitësit, duke përfshirë të gjitha
nenet, kushtet e përgjithshme, kushtet e veçanta, si edhe shtojcat e listës A dhe listës B të kësaj
kontrate.

1.2 “Blerësi” nënkupton autoritetin kontraktues, Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë.

1.3 “Shitësi” nënkupton kontraktuesin, EUROCOPTER S.A.S.

1.4 “Furnizimet” nënkupton helikopterët, pjesët e këmbimit dhe mjetet, trajnimin dhe
dokumentacionin që do të sigurohet nga Shitësi te Blerësi sipas kësaj kontrate. “Furnizimet”, sipas
kësaj kontrate, në mënyrë më specifike do të përfshijnë:

1.4.1 “Helikopterët” nënkupton të gjithë apo secilin helikopter AS532 AL COUGAR, siç
përcaktohet në konfigurimin teknik në shtojcën 1 “Konfigurimi i helikopterit”. AS532 AL
COUGAR është një nga versionet ushtarake të familjes Super PUMA.

1.4.2 “Pjesët e këmbimit dhe mjetet” nënkupton pjesët e këmbimit dhe mjetet siç janë
përcaktuar në listën B, shtojca teknike.

1.4.3 “Trajnimet” nënkupton trajnimet siç përshkruhen në nenin 17.

1.4.4 “Dokumentacion” nënkupton dokumentacionin teknik, siç përkufizohet në nenin 18.

1.5 “Çmimi i kontratës” nënkupton shumën totale për furnizimet e pagueshme nga Blerësi te Shitësi, sipas kësaj kontrate në përputhje me nenin 9.

1.6 “Certifikata e përputhshmërisë” ose “Deklarata e përputhshmërisë” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Organizata e Sigurimit të Cilësisë së Shitësit, mbas mbarimit të procedurave të miratuara nga autoritetet përkatëse, duke vërtetuar përputhshmërinë e helikopterëve me standardet dhe specifikimet e zbatueshme të prodhuesit.

1.7 “Certifikata e përfundimit” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Organizata e Sigurimit të Cilësisë së Shitësit, mbas përfundimit të procedurave të miratuara nga autoritetet përkatëse, që vërteton përputhshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe mjeteve, trajnimeve dhe dokumentacionit me standardet dhe specifikimet e zbatueshme të prodhuesit.

1.8 “Protokolli i dorëzimit dhe kalimit të pronësisë” nënkupton protokollin e nënshkruar nga Blerësi pas procedurës së dorëzimit të fabrikës që njeh se helikopterët janë në përputhshmëri me specifikimet kontraktore.

1.9 “Protokolli përfundimtar i dorëzimit” nënkupton protokollin e nënshkruar nga Blerësi dhe Shitësi, duke marrë parasysh që të gjitha rreziqet që lidhen me humbjen ose dëmtimin e furnizimeve i kalojnë Blerësit, siç përshkruhet në nenin 13.5.

1.10 “Data efektive e kontratës” ose “CED” nënkupton datën e marrjes së pagesës së kështit të parë (siç përcaktohet në nenin 11.2.1).

1.11 “Data e dërgimit” nënkupton datën kur certifikata e përputhshmërisë ose deklarata e përputhshmërisë është lëshuar për furnizimet dhe certifikata e përfundimit për pjesët e këmbimit dhe mjetet, trajnimet dhe dokumentacionin.

1.12 “Vendndodhja e Blerësit” nënkupton Farkë, Tiranë, Shqipëri.

1.13 “Raportprogresi i punës” nënkupton raportin e përshkruar në shtojcën 10.

1.14 “Certifikata e ecurisë së punës” nënkupton certifikatën e përshkruar në shtojcën 10.

1.15 “Inspektimi i ecurisë së punës” nënkupton procedurën e inspektimit të përshkruar në shtojcën 10.

Terma të tjerë me shkronja kapitale kanë kuptim të përcaktuar diku tjetër në kontratë.

Neni 2

Qëllimi i kontratës

Në përputhje me këtë kontratë të nënshkruar në 17 dhjetor 2009 dhe pas pagesës së çmimit të kontratës, sipas termave të përcaktuar me hollësi në nenin 11 si më poshtë, Shitësi bie dakord të shesë dhe Blerësi bie dakord të blejë sasinë e përcaktuar prej:

Pesë (5) helikopterësh AS532 AL COUGAR për qëllime ushtarake, bashkë me pjesët e këmbimit dhe mjetet, publikimin teknik dhe trajnimin, bashkërisht të quajtura furnizime.

Neni 3

Pronësia intelektuale

Shitësi ruan të gjitha të drejtat në lidhje me zhvillimet, shpikjet, procedurat e prodhimit dhe çdo të drejtë të pronësisë intelektuale, në lidhje me subjektin e kontratës. Kopjimi dhe/ose riprodhimi i furnizimeve ose publikimeve të Shitësit, qofshin të plota ose të pjesshme, pa miratimin e shprehur të Shitësit, është e paligjshme.

Asgjë në këtë Kontratë nuk do të interpretohet si një kalim i ligjshëm i çdo patente, pajisje ose modeli projektimi, të drejtë autori, marke tregtare ose të drejtë të pronësisë intelektuale.

Neni 4

Ligji i zbatueshëm

Kontrata rregullohet nga legjislacioni shqiptar, me përjashtim të dispozitave të saj, që lidhen me fabrikimin e furnizimeve dhe / ose shërbimeve të tjera të kryera nga Shitësi në Francë, të cilat i nënshtrohen legjislacionit francez.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin miqësisht çdo mosmarrëveshje, kontradiktë apo pretendim të cilat rrjedhin nga apo lidhen me kontratën.

Nëse pas 2(dy) muajsh nga zhvillimi i kësaj mosmarrëveshjeje, kontradikte ose pretendimi, palët dështojnë të arrijnë në një marrëveshje, atëherë mosmarrëveshja, kontradikta ose pretendimi do të zgjidhet përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga tre arbitra të caktuar, në përputhje me rregullat në fjalë.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Gjenevë, (Zvicër).

Gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

Palët shprehimisht heqin dorë nga kërkimi i të drejtave të tyre për imunitet nga juridiksioni dhe imunitet nga ekzekutimi.

Përveç kur bihet dakord ndryshe nga të dyja palët, fakti që cilado mosmarrëveshje i është referuar arbitrazhit në pajtim me këtë dispozitë, nuk do ta lirojë asnjërën palë nga çdo detyrim i tyre siç përcaktohet në këtë kontratë. Vendimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për palët.

Neni 6

Të ndryshme

6.1 Tërësia e kontratës dhe ndryshimet

Këto terma dhe kushte të përgjithshme, bashkë me kushtet e veçanta të përmbajtura dhe pranuar shprehimisht në këtë kontratë, përbëjnë të gjithë marrëveshjen midis Shitësit dhe Blerësit. Ato zëvendësojnë të gjitha komunikimet ose marrëveshjet e mëparshme, të shkruara ose verbale, midis Shitësit dhe Blerësit në lidhje me furnizimet. Çdo ndryshim i kontratës do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është rënë dakord me shkrim nga palët.

Moszbatimi ose mosaplikimi i Shitësit në çdo kohë të çdo klauzole ose dispozite të kësaj kontrate, nuk do të interpretohet në asnjë mënyrë si heqje dorë, e tashme ose e ardhshme, nga kjo dispozitë apo klauzolë, e as do të prekë në asnjë mënyrë vlefshmërinë e kësaj kontrate ose ndonjë pjesë të saj, ose të drejtën e Shitësit që pas kësaj të zbatojë secilin dhe cilindo nga këto dispozita.

Në rast së një ose më shumë klauzola të parashikuara në këtë kontratë vlerësohen si të pavlefshme apo të pazbatueshme, dispozitat që mbeten do të qëndrojnë plotësisht të vlefshme dhe të zbatueshme. Dhe dispozitat e pavlefshme do të zëvendësohen nga dispozita që përmbushin në masën që është e mundur qëllimin ligjor dhe ekonomik të dispozitave të konsideruara si të pavlefshme ose të pazbatueshme.

6.2 Konfidencialiteti

Blerësi dhe Shitësi njohin natyrën konfidenciale dhe të rezervuar të dokumentacionit dhe informacionit të siguruar në lidhje me furnizimet. Përveç kur është rënë dakord ndryshe me shkrim paraprakisht, Blerësi nuk do të kopjojë apo publikojë asnjë informacion që sigurohet drejtpërdrejt apo tërthorazi gjatë ose pas zbatimit të kësaj kontrate.

Në rast shkelje të këtij konfidencialiteti, Shitësi dhe Blerësi do të kenë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga dhe kundrejt palës që ka bërë publikimin.

6.3 Gjuha

Kontrata është shkruar në dy versione, një në anglisht dhe një në shqip. (Përveç shtojcave të cilat do të jenë të shkruara vetëm në anglisht.)

Në rast mosmarrëveshje midis palëve, do të mbizotërojë versioni anglisht.

Të dyja palët do të përdorin gjuhën angleze si gjuhën për shkëmbimin e informacioneve dhe njoftimeve, sipas nenit 8.

Neni 7
Caktimi

Blerësi nuk do të ketë të drejtë, pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të Shitësit, për t'i caktuar ose kaluar një pale të tretë një pjesë ose të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj kontrate.

Neni 8
Korrespondenca

I gjithë komunikimi, korrespondenca, raportet ndërmjet palëve do të jenë në anglisht me një konfirmim të marrjes së njoftimit.

Të gjitha komunikimet do t'i drejtohen:

Shitësit:

Shitjet dhe Marrëdhëniet me Klientët

Adresa: EUROCOPTER DEUTSCHLAND GmbH
D-86607 DONAUWÖRTH
GERMANY

Në vëmendje të: Dr. Ralf WEBER
Telefon : +49 906 71 3499
Telefaks: +49 906 71 4078
E.mail: Ralf.weber@eurocopter.com

Menaxhimi i Programit

Adresa: EUROCOPTER
Aeroport Internationale Marseille Provence
Marignane 13725
FRANCE

Në vëmendje të: Jerome JAUSSAUD
Telefon: +33 4428 57757
E.mail: Jerome.jaussaud@eurocopter.com

Blerësit:

Adresa: (MODERNIZATION PROJECT MANAGEMENT DIRECTORATE) mod
DREJTORIA E MENAXHIMIT të PROJEKTEVE të MODERNIZIMIT
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Tirana, Shqipëri (Albania)

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë

Në vëmendje të: Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Projekteve të Modernizimit
Telefon : + 355 4 225 52 32
Telefaks: + 355 4 225 52 26
E.mail : dmpm@mod.gov.al

B. KUSHTET E VEÇANTA

Neni 9 Çmimi

9.1 Çmimi i kontratës

Pesë (5) helikopterët AS532 AL COUGAR dhe pjesët e këmbimit dhe mjetet përkatëse, siç porositen saktësisht, do të dërgohen DDU (DDU, sipas edicionit të INCOTERMS 2000) në Farkë, Tiranë, Shqipëri, të papaketuar.

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi DDU në euro
1	Helikopter shumë funksionesh AS532 AL Sipas konfigurimit të përcaktuar me hollësi në vëllimin 3: shtojca 17; propozimi tregtar i Eurocopter + Garanci 500 orë fluturimi ose 12 muaj për helikopterin ose pajisjet opsionale, cilado që skadon përpara.	Pesë (5) MRH	69 742 814 €
2	Niveli I & II i pjesëve të këmbimit dhe mjeteve të mirëmbajtjes	1 paketë për të pesë (5) helikopterët	1 921 576 €
3	Çmimi total i kompleteve të pajimeve 1x komplet VIP, 1x komplet SAR, 1 x komplet MEDEVAC, 2 x komplet për transport trupash)	5	6 446 800 €
4	Çmimi i trajnimit të pilotit (10 pilotë)	10	375 300 €
5	Çmimi i trajnimit të instruktorit të pilotit (2 pilotë)	2	47 798 €
6	Çmimi i trajnimit të teknikut	5	75 000 €
7	Çmimi i trajnimit të teknikut për "Avionic" (për sistemet elektronike aeronautike)	2	24 000 €
	Oferta totale =		78 633 288 €

Në rast se kjo kontratë nuk do të hyjë në fuqi para 31 dhjetorit 2009, këto çmime mund të rregullohen sipas ndryshimeve të reja kohore të lëvrimit dhe kushteve financiare përkatëse.

9.2 Çmimet

Çmimet në këtë kontratë janë për furnizimet e dërguara DDU (DDU edicioni i INCOTERMS 2000), në Farkë Tiranë, Shqipëri, të papaketuara, sipas konfigurimit të helikopterit të përcaktuar me hollësi në shtojcën 1.

Të gjitha çmimet në këtë kontratë janë në monedhën euro (EUR) në llogaritje dhe pagesa.

Ato përfshijnë të gjitha shpenzimet dhe taksat në lidhje me fabrikimin e furnizimeve, duke përfshirë TVSH-në.

Ato përfshihen nga çdo detyrim që rrjedh nga rregullat administrative dhe legislative në fuqi, në shtetin e Blerësit dhe çdo detyrim tatimor dhe doganor, të cilat janë përgjegjësi e Blerësit.

Çmimet u referohen furnizimeve të përmendura shprehimisht në këtë kontratë. Çdo ndryshim konfigurimi dhe / ose furnizime shtesë dhe / ose shërbime për t'u siguruar nga Shitësi, duhet të bihet dakord paraprakisht me shkrim dhe do t'i nënshtrohen një ndryshimi në kontratë, duke parashtruar çdo ndryshim në çmim dhe në programin e dërgimit.

Neni 10

Autorizimi / licenca e eksport/importit

Nëse furnizimet dhe / ose shërbimet, sipas kësaj kontrate, kërkojnë çdo autorizim / licencë zyrtare, Shitësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe do të ndjekë procedurat e duhura për t'i siguruar këto licenca / autorizime.

Nëse kërkohet përfshirja e Blerësit, atëherë Blerësi do të japë ndihmesën e vet pa asnjë vonesë.

Nëse një licencë / autorizim i tillë nuk jepet dhe / ose jepet me vonesë, dhe / ose nëse një licencë / autorizim që është marrë më parë hiqet dhe / ose nëse një licencë / autorizim nuk jepet në momentin e ripërtëritjes së tij, Blerësi nuk ka të drejtë të ngrejë pretendime ndaj Shitësit në lidhje me këtë. Në një rast të tillë, Shitësi ka të drejtë të përfundojë kontratën, sipas kushteve të parashtruara në nenet 12.4.2 Forca madhore dhe 21.3 Përfundimi për forcë madhore.

Licencat / autorizimet e eksportit zakonisht jepen për një qëllim përfundimtar / përdorues përfundimtar të caktuar. Çdo ndryshim në qëllimin përfundimtar / përdoruesin përfundimtar të furnizimeve dhe / ose shërbimeve korresponduese, kërkon autorizimin paraprak të qeverive që kanë lëshuar licencat / autorizimin në fjalë të eksportit.

Si rrjedhim, Blerësi do të njoftojë Shitësin përpara çdo kalimi të kontrollit, zotërimit, regjistrimit, titujve, pronësisë etj. të furnizimeve dhe / ose shërbimeve tek cilado palë e tretë, në mënyrë që të lejojë Blerësin të vlerësojë masat e nevojshme që do të ndërmerren dhe procedurat që do të zbatohen. Pastaj Blerësi do të ndjekë udhëzimet e dhëna nga Shitësi.

Nëse një licencë / autorizim i tillë nuk jepet ose jepet me vonesë ose nëse një licencë / autorizim që është marrë më parë hiqet, Blerësi nuk ka të drejtë të ngrejë pretendime ndaj Shitësit në lidhje me këtë.

Blerësi do të sigurojë personalisht në kohën e duhur çfarëdo autorizim / licencë importi që kërkohet në vendin e tij për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfshira në këtë kontratë.

Neni 11

Termet e pagesës

11.1 Të përgjithshme

Të gjitha pagesat sipas kësaj kontrate do të bëhen pa mbajtjen e ndonjë takse, kuote, tatimi, tarife, takse dhe detyrimi tjetër.

Monedha e llogaritjes, faturimit dhe pagesës do të jetë monedha europiane euro (EUR).

Të gjitha pagesat ndaj Shitësit sipas kësaj kontrate, me përjashtim të pagesës së kështit të parë dhe të dytë, sipas nenit 11.2.1 dhe 11.2.2, do të bëhen nëpërmjet 4 (katër) letrave të kreditit ("Dokument krediti") të konfirmuara, të parevokueshme dhe të patransferueshme, lëshuar çdo vit në vijim nga një bankë ndërkombëtare e nivelit të parë me një degë në Shqipëri, të pranuar me shkrim nga Shitësi. Ky dokument krediti duhet të konfirmohet në favor të Shitësit, nëpërmjet një banke ndërkombëtare të nivelit të parë ("Banka konfirmuese"). Banka konfirmuese gjithashtu do të veprojë si bankë këshilluese dhe bankë paguese.

Një dokument krediti i parë do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se 1 tetori 2010 për shumën e 7 600 000.00 (shtatë milionë e gjashtëqind mijë) euro, për të mbuluar shumën e

kërkuar të pagesës së parë të ecurisë së punës (neni 11.3.1). Ky dokument krediti do të jetë i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2010.

Një dokument krediti i dytë do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se 10 marsi 2011 për shumën e 20 000 000.00 (njëzet milionë) euro për të mbuluar shumën e kërkuar të pagesës së dytë të ecurisë së punës (neni 11.3.2) dhe pagesën e mbetur për helikopterin të parë (neni 11.4.1). Ky dokument krediti do të jetë i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2011.

Një dokument krediti i tretë do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se 10 marsi 2012 për shumën e 20 000 000.00 (njëzet milionë) euro për të mbuluar shumën e pagesës së mbetur për helikopterin e dytë dhe të tretë (nenet 11.4.2 dhe 11.4.3). Ky dokument krediti do të jetë i vlefshëm deri më 30 shtator 2012.

Një dokument krediti i katërt do të hapet me urdhër të Blerësit jo më vonë se 20 shkurti 2013 për shumën e 17 170 698.00 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) euro për të mbuluar shumën e pagesës së mbetur të helikopterit të katërt dhe të pestë (nenet 11.4.4 dhe 11.4.5) Ky dokument krediti do të jetë i vlefshëm deri më 30 qershor 2013.

Palët bien dakord të përdorin formularin e dokumentit të kreditit, bashkëlidhur në shtojcën 5.

Në rast se Blerësi dështon në hapjen e cilitdo nga dokumentet e kreditit brenda periudhës së përmendur më sipër, çdo vonesë në hapjen e këtij dokumenti krediti pas datave të mësipërme, detyron shtyrjen me të njëjtën periudhë vonesë në programin e dërgimit të përshkruar në nenin 12.

Nëse dokumenti i kreditit skadon përpara se të përfundojë dërgimi i plotë i furnizimeve, Blerësi do të bëjë në kohën e duhur një shtyrje me kërkesën dhe shpenzimet e Shitësit.

Shitësi mund të kërkojë modifikime të cilitdo nga dokumentet e kreditit nëse ato nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate (përfshirë shtojcën 5) dhe Blerësi merr përsipër të modifikojë dokumentin e kreditit me shpenzimet e tij përkatësisht brenda 30 ditëve pas kërkesës së Shitësit.

Të gjitha tarifat e lëshimit të dokumentit të kreditit, si edhe të gjitha detyrimet e tjera përkatëse që lindin në shtetin e Blerësit përballohen nga Blerësi dhe të gjitha tarifat që lindin jashtë shtetit të Shitësit përballohen nga Shitësi duke përfshirë këtu edhe tarifat e konfirmimit.

Ky dokument krediti u nënshtrohet rregullave dhe praktikave të njëjtësuarra për dokumentet e kreditit 2007, rishikimi i I.C.C, publikimi nr. 600.

Detyrimet e pagesës do të quhen të përbushura në momentin që shuma e plotë kreditohet në mënyrë të parevokueshme në llogaritë bankare të EUROCOPTER, si përcaktohet më poshtë.

11.2 Paradhënia

11.2.1 Pagesa e kështit të parë e pagueshme në dhjetor 2009

Jo më vonë se 31 dhjetori 2009, Blerësi do t'i bëjë Shitësit një pagesë të kështit të parë në shumën 6 262 500.00 (gjashtë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) euro nëpërmjet transfertës elektronike në llogarinë bankare të Blerësit, përmendur më poshtë kundrejt paraqitjes së një fature tregtare në një kopje origjinale dhe dy kopje të lëshuara nga Shitësi me shumën korresponduese.

Emri i bankës : NATIXIS
Numri i llogarisë : Iban : F R 7 6 3 0 0 0 7 5 3 0 3 7 0 4 5 3 2 8 8 7 0 0 0 7 4
Swift Code (BIC): CCBPFRPP926

11.2.2 Pagesa e kështit të dytë e pagueshme në prill 2010

Jo më vonë se 1 prill 2010, Blerësi do t'i bëjë Shitësit një pagesë të kështit të dytë në shumën 7 600 000.00 (shtatë milionë e gjashtëqind mijë) euro nëpërmjet transfertës elektronike në llogarinë bankare të Blerësit, përmendur më lart, kundrejt paraqitjes së një fature tregtare në një kopje origjinale dhe dy kopje të lëshuara nga Shitësi me shumën korresponduese dhe një kopje të garancisë bankare të lëshuar nga një bankë në Francë (si modeli i dhënë në shtojcën 7) për një shumë prej 5 000 000.00 (pesë milionë) euro, në përputhje me nenin 1.5.2.

11.3 Pagesat e ndërmjetme

11.3.1 Pagesa e ecurisë së punës e pagueshme në dhjetor 2010

Një sasi prej 7 600 000.00 (shtatë milionë e gjashtëqind mijë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet dokumentit të kreditit, sipas kërkesës, në kohën e Raportit të Progresit të Punës të përshkruar në shtojcën 10 jo më vonë se më 31 dhjetor 2010, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të një fature tregtare në një kopje origjinale dhe dy kopje të lëshuara nga Shitësi për shumën korresponduese dhe një kopje të certifikatës së ecurisë së punës, në përputhje me shtojcën 10.

Nëse Blerësi nuk dërgon njerëzit e tij për inspektimin e ecurisë së punës, në përputhje me shtojcën 10, pa ndonjë justifikim për 30 ditë pas dërgimit të njoftimit të ftesës nga Shitësi, ky njoftim i ftesës dhe certifikata e ecurisë së punës, e nënshkruar nga Shitësi, do të jenë të vetmet dokumente që do t'i paraqiten bankës për pagesë.

11.3.2 Pagesa e ecurisë së punës e pagueshme në prill 2011

Një sasi prej EUR 8 000 000.00 (tetë milionë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet dokumentit të kreditit, sipas kërkesës, në kohën e Raportit të Progresit të Punës të përshkruar në shtojcën 10 jo më vonë se 30 prill 2011 kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese, të një fature tregtare në një kopje origjinale dhe dy kopje të lëshuara nga Shitësi për shumën korresponduese dhe një kopje të certifikatës së ecurisë së punës, në përputhje me shtojcën 10.

Nëse Blerësi nuk dërgon njerëzit për inspektimin e ecurisë së punës, në përputhje me shtojcën 10, pa ndonjë justifikim për 30 ditë pas dërgimit të njoftimit të ftesës nga Shitësi, ky njoftim i ftesës dhe certifikata e ecurisë së punës, e nënshkruar nga Shitësi, do të jenë të vetmet dokumente që do t'i paraqiten bankës për pagesë.

11.4 Pagesat e mbetura:

11.4.1 Pagesa e mbetur për helikopterin e parë

Një sasi prej EUR 12 000 000.00 (dymbëdhjetë milionë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një dokumenti krediti, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të:

- A. Faturës tregtare në një kopje origjinale, plus dy kopje të lëshuara nga shitësi.
- B. Certifikatës së përputhshmërisë ose deklaratës së përputhshmërisë në një fotokopje lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e parë.
- C. Protokollit të dorëzimit dhe kalimit të pronësisë lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e parë.
- D. Deklaratës së uljes (“deklarata e uljes”) në përputhje me modelin bashkëlidhur në shtojcën 8.

11.4.2 Pagesa e mbetur për helikopterin e dytë

Një sasi prej 10 000 000.00 (dhjetë milionë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet dokumentit të kreditit, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të dytë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të:

- A. Faturës tregtare në një kopje origjinale, plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi.
- B. Certifikatës së përputhshmërisë ose deklaratës së përputhshmërisë në një fotokopje lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e dytë.
- C. Protokollit të dorëzimit dhe kalimit të pronësisë lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e dytë.
- D. Deklaratës së uljes (“deklarata e uljes”) në përputhje me modelin bashkëlidhur në shtojcën 8.

11.4.3 Pagesa e mbetur për helikopterin e tretë

Një sasi prej 10 000 000.00 (dhjetë milionë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet dokumentit të kreditit, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të tretë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të:

- A. Faturës tregtare në një kopje origjinale, plus dy kopje të lëshuara nga Shitësi.

B. Certifikatës së përputhshmërisë ose deklaratës së përputhshmërisë në një fotokopje lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e tretë.

C. Protokollit të dorëzimit dhe kalimit të pronësisë lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e tretë.

D. Deklaratës së uljes (“deklarata e uljes”) në përputhje me modelin bashkëlidhur në shtojcën 8.

11.4.4 Pagesa e mbetur për helikopterin e katërt

Një sasi prej 8 595 598.00 (tetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet dokumentit të kreditit, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të katërt në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të:

A. Faturës tregtare në një kopje origjinale, plus dy kopje të lësuara nga Shitësi.

B. Certifikatës së përputhshmërisë ose deklaratës së përputhshmërisë në një fotokopje lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e katërt.

C. Protokollit të dorëzimit dhe kalimit të pronësisë lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e katërt.

D. Deklaratës së uljes (“deklarata e uljes”) në përputhje me modelin bashkëlidhur në shtojcën 8.

11.4.5 Pagesa e mbetur për helikopterin e pestë

Një sasi prej 8 575 000.00 (tetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) euro do të jetë e pagueshme ndaj Shitësit nëpërmjet një dokumenti krediti, sipas kërkesës, pas uljes së helikopterit të pestë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Tiranë, kundrejt paraqitjes nga Shitësi në bankën konfirmuese të:

A. Faturës tregtare në një kopje origjinale, plus dy kopje të lësuara nga Shitësi.

B. Certifikatës së përputhshmërisë ose deklaratës së përputhshmërisë në një fotokopje lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e pestë.

C. Protokollit të dorëzimit dhe kalimit të pronësisë lëshuar nga EUROCOPTER për helikopterin e pestë.

D. Deklaratës së uljes (“deklarata e uljes”) në përputhje me modelin bashkëlidhur në shtojcën 8.

11.5 Garancitë bankare

11.5.1 Formulari i garancisë

Për të siguruar plotësimin e kontratës do të lëshohet një formular garancie me shumën prej 7 863 328.80 (shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e tetë e tetëdhjetë) euro që përfaqëson dhjetë për qind (10 %) të shumës totale të kontratës që lëshohet në favor të Blerësit.

Ky formular garancie do të lëshohet në formën e një detyrimi përmbushjeje nga një bankë ndërkombëtare e klasit të parë në Francë.

Ky detyrim përmbushjeje do të bëhet efektiv nga data e hyrjes në fuqi të kontratës, e cila do të njoftohet në Bankë nga Blerësi menjëherë pas marrjes së pagesës së kështit të parë (neni 11.2.1) dhe do të jetë i vlefshëm 30 ditë pas dërgimit të helikopterit të fundit ose jo më vonë se data 31 maj 2013.

Detyrimi i përmbushjes do t’u nënshtrohet rregullave uniforme të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për kërkesën e garancive, publikimi nr. 458, i cili do të jetë detyrues për palët, me përjashtim të rasteve kur ato nuk janë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Një model i detyrimit të përmbushjes tregohet në shtojcën 6.

11.5.2 Garancia bankare

Shitësi do të lëshojë një garanci bankare me një shumë prej 5 000 000.00 (pesë milionë) euro në favor të Blerësit (“Garancia bankare”).

Kjo garanci bankare do të lëshohet nga një bankë ndërkombëtare e klasit të parë në Francë jo më vonë se data 1 mars e vitit 2010.

Ajo do të jetë e vlefshme nga data e marrjes së pagesës së këstit të dytë në llogarinë e Shitësit, e cila do të njoftohet në bankë nga Shitësi menjëherë pas marrjes së pagesës së këstit të dytë deri në datën 31 mars 2011.

Garancia bankare do t'u nënshtrohet rregullave uniforme të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për kërkesën e garancive, publikimi nr. 458, i cili do të jetë detyrues për palët, me përjashtim të rasteve kur ato nuk janë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Një model i kësaj garancie bankare tregohet në shtojcën 7.

Neni 12

Dërgimi

12.1 Të përgjithshme

Helikopterët do të dërgohen me traget DDU (Edicioni i vitit 2000 i DDU INCOTERMS) në Farkë, Tiranë, Shqipëri, të papaketuar.

Shitësi mund të kryejë teste fluturimi për prodhimin dhe fluturime inspektimi në helikopterin / helikopterët e Blerësit, duke mos tejkaluar tridhjetë (30) orë fluturimi.

Orë shtesë fluturimi mund të zhvillohen në rastet e kërkuara nga Blerësi për zhvillimin dhe instalimin e pajisjeve të posaçme.

Pjesët e këmbimit, mjetet dhe pajisje të ndryshme të blera bashkë me helikopterët do të dërgohen me DDU në vendndodhjen e përcaktuar në marrëveshje midis Blerësit dhe Shitësit në Tiranë, Shqipëri.

12.2 Datat e dërgimit

Helikopterët do të dërgohen në përputhje me konfigurimin e caktuar në shtojcën 1 që këtu e në vijim dhe siç deklarohet më poshtë, me kusht që kontrata të hyjë në fuqi përpara datës 31 dhjetor 2009:

- Para 15 nëntorit 2011 – Konfigurimi VIP
- Para 30 qershorit 2012 – Konfigurimi CSAR
- Para 31 korrikut 2012 – Konfigurimi MEDEVAC
- Para 30 prillit 2013 – Konfigurimi TTH
- Para 31 majit 2013 – Konfigurimi TTH

Në rast se kontrata nuk do të hyjë në fuqi përpara datës 31 dhjetor 2009, të dyja palët bien dakord të llogarit numërimin e muajve të punës (duke përjashtuar një muaj në vit për mbylljen e fabrikës për periudhën e pushimeve) duke filluar nga marrja e pagesës së këstit të parë, sipas nenit 11.2.1 ("TO"), si më poshtë:

- T0" + 23 muaj pune- Konfigurimi i VIP.
- T0" + 30 muaj pune –Konfigurimi CSAR
- T0" + 31 muaj pune –Konfigurimi MEDEVAC
- T0" + 43 muaj pune –Konfigurimi TTH
- T0" + 46 muaj pune – Konfigurimi TTH

Data e dërgimit do të jetë data kur do të lëshohet certifikata e përputhshmërisë apo deklarata e përputhshmërisë.

Pas dorëzimit teknik në Marignane, Francë, helikopteri do të dërgohet me DDU me traget (DDU INCOTERMS 2000) nga Marignane, Francë në Tiranë, Shqipëri, brenda një muaji nga data e dërgimit, me kusht që mos të ketë vonesa të shkaktuara nga Blerësi.

Nëse nuk parashikohet ndryshe, çdo datë e dërgimit e shënuar si një muaj kalendarik pa një datë fikse do të jetë dita e fundit e punës së atij muaji.

Zbatimi i datës së dërgimit kushtëzohet nga përmbushja e të gjitha detyrimeve kontraktuale të Blerësit, veçanërisht përsa u përket detyrimeve të Blerësit për të hapur dokumentet vjetore të kreditit, sipas nenit 11 dhe për të vepruar në përputhje me datat e pagesave të përcaktuara në nenin 11.

Furnizimet do të mbeten të siguruara nga Shitësi ndaj rreziqeve të dëmtimit dhe zjarrit në momentin e vendosjes në aerodrom deri në nënshkrimin e protokollit përfundimtar të dërgimit.

12.3 Dërgimi i pjesëve të këmbimit dhe mjeteve
Pjesët e këmbimit dhe mjetet do të dërgohen me DDU (edicioni i DDU INCOTERMS 2000).

Pjesa e mbetur e pjesëve të këmbimit dhe mjeteve do të vihet në dispozicion e papaketuar, në të njëjtën kohë të dërgimit të çdo helikopteri.

12.4 Vonesat

12.4.1 Shtyrja

Çdo vonesë në datat e pagesës nga Blerësi siç përcaktohet në nenin 11, do të përfshijë të njëjtën kohë shtyrjeje në tabelën e lëvrimit, siç përshkruhet në nenin 12.2.

12.4.2 Forca madhore

Palët nuk do të mbajnë përgjegjësi për mosarritjen e përmbushjes ose për vonesat e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kësaj kontrate, nëse këto mospërmbushje vijnë si pasojë e ngjarjeve të paparashikueshme përtej kontrollit të tyre të arsyeshëm, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në forca madhore, luftë, kryengritje, epidemi, sabotime, konflikte midis punonjësve, greva, ndërprerje pune, shkurtime të punonjësve, ndërprerje ose vonesa në transportim, zjarre, shpërthime, prishje të makinerive ose pajisjeve, mosarritje ose vonesa në burimet për mjetet, sasi të pakët në materiale ose energji, veprime, rregulla ose përparësi të çdo qeverie dhe embargo.

Pala e ndaluar do të informojë palën tjetër rreth ndodhjes së ndonjë ngjarjeje nga forca madhore brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e fillimit, duke e cituar këtë paragraf në lajmërimin e lartpërmendur. Në rast të tillë, data e dërgimit kontraktual do të shtyhet në një kohë të arsyeshme që kërkohet për eliminimin e shkaqeve të vonesave.

Nëse një palë pengohet nga një forcë madhore më shumë se 6 (gjashtë) muaj pas datës së dërgimit të kontratës, secila palë ka të drejtën për ta ndërprerë kontratën, në përputhje me nenin 21.

12.4.3 Vonesat e pranueshme

Çdo shtyrje e datës së dërgimit nga shkaqet e mëposhtme nuk do të përbëjë një vonesë në dërgim:

- Ndryshimet ose shtesat në kontratë të kërkuara nga Blerësi pas nënshkrimit të kontratës ose,

- Çdo mosarritje nga Blerësi në përmbushjen e detyrimeve të tij, në përputhje me këtë kontratë, ose

- Çdo shkak force madhore, siç përcaktohet në nenin 12.4.2.

Për më tepër, çdo kosto shtesë e shkaktuar nga Shitësi, si rezultat i angazhimit me punë ose ri-programimit të instalimit të pajisjeve të dhëna Blerësit për shkak të mosarritjes nga ana e Blerësit që të sigurojë pajisje plotësisht operative dhe të rregullta në mënyrën e duhur, do t'i faturohet dhe paguhet nga Blerësi mbi çmimin e kontratës.

Neni 13

Procedurat e dorëzimit

13.1 Protokolli i dorëzimit

Në mënyrë treguese, 1 (një) muaj përpara datës në të cilën helikopteri është gati për inspektimin dhe dorëzimin e Blerësit, Shitësi do t'i sigurojë Blerësit një program të saktë, një program të dërgimit dhe procesi për inspektimin.

Informacioni personal që kërkohet për përfaqësuesit e Blerësit, në mënyrë që të dorëzohen në ambientet e Shitësit, do të paraqitet nga Blerësi te Shitësi në këtë kohë. Për më tepër, Blerësi ka të drejtë të përcaktojë deri në 5(pesë) pjesëmarrës nga palë të treta, në mënyrë që të ndihmojnë gjatë procedurës së dorëzimit, me kusht që emrat dhe të dhënat e pjesëmarrësve t'i njoftohen Shitësit me shkrim një muaj më parë. Shitësi ka të drejtën të refuzojë ndonjë apo të gjithë pjesëmarrësit mbi baza të arsyeshme.

Me përfundimin e kënaqshëm të procedurave të sigurimit të cilësisë të Shitësit, të miratuara nga autoritetet përkatëse, një dokument për vërtetimin e përputhshmërisë së helikopterit ("Certifikata e përputhshmërisë" apo "Deklarata e përputhshmërisë") do të lëshohet nga departamenti i cilësisë së Shitësit.

Pas datës së nxjerrjes së këtij dokumenti, helikopteri do të çmohet se është gati për pranimin nga Blerësi.

Përveç rasteve kur konstatohet ndonjë shmangie e konsiderueshme gjatë inspektimit të pranimin, Blerësi do të pranojë furnizimet, në përputhje me specifikimet kontraktuale. Dorëzimi do të konfirmohet nga nënshkrimi nga ana e Blerësit i protokollit të dorëzimit sipas shtojcës 3 (“Protokolli i pranimin”).

Blerësi do të përballojë shpenzimet e tij dhe kostot e lidhura me procedurën e dorëzimit, duke përfshirë, por jo kufizuar në ato të lidhura me qëndrimin e përfaqësuesve gjatë këtij procesi. Nëse procedurat e pranimin shtyhen për faj të Shitësit, Shitësi do të përballojë kostot e arsyeshme shtesë të Blerësit për ditët shtesë.

13.2 Fluturimet e dorëzimit nga blerësi

Gjatë procedurës së dorëzimit, Blerësi mund të kryejë falas fluturime dorëzimi, koha e kombinuar e të cilave nuk do të tejkalojë:

2 (dy) orë.

Fluturimet për dorëzim do të ndjekin formatin dhe procedurat e siguruara nga Shitësi dhe do të zbatohen nën përgjegjësinë e pilotit të Shitësit, duke vepruar si një pilot në komandim.

13.3 Kalimi i pronësisë

Kalimi i pronësisë së helikopterëve, si dhe i pjesëve të këmbimit dhe mjeteve do të kryhet në ambientet e EUROCOPTERS në Marignane pas dorëzimit dhe do të materializohet nëpërmjet nënshkrimit të protokollit të pranimin dhe kalimit të pronësisë, siç përcaktohet në shtojcën 4.

13.4 Vonesat e dorëzimit dhe / ose pagesave të blerësit

Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pasi helikopteri të jetë gati për dorëzim, Blerësi nuk arrin të marrë pjesë në dorëzimin e helikopterit pa ndonjë justifikim të arsyeshëm dhe me shkrim, pronësia do të mbetet e Shitësit derisa të plotësohen detyrimet kontraktuale nga Blerësi. Të gjitha shpenzimet që lidhen me këtë, si magazinimi, mirëmbajtja dhe sigurimet do t'i transferohen dhe faturohen Blerësit.

13.5 Transferimi i rrezikut

Transferimi i rrezikut të helikopterit do të bëhet jo më vonë se një muaj duke filluar nga data e dërgimit në vendndodhjen e Blerësit pas transportimit të helikopterit nga Marseja, Francë sipas DDU Incoterms 2000.

Një protokoll përfundimtar i dorëzimit do të nënshkruhet nga palët në vendndodhjen e Blerësit brenda 2 (dy) ditëve duke filluar nga mbërritja e furnizimeve në vendndodhjen e Blerësit.

Në rast se Blerësi ka kërkuar trajnim shtesë të pilotit pas dorëzimit të helikopterit, kohëzgjatja prej një muaji e përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 13.5, do të zgjatet me kohën e nevojshme për trajnimin e pilotit (ve) të helikopterit.

Nëse Blerësi nuk arrin të përmbushë protokollin përfundimtar të dorëzimit brenda kohës së lartpërmendur, çdo shpenzim i bërë nga Shitësi për sigurimin do të paguhet nga Blerësi për Shitësin.

13.6 Kthimi i kontenierëve të pjesëve të këmbimit

Në rast se pjesët e këmbimit dërgohen në kontenierë të lënë në ngarkim, Blerësi do t'i kthejë kontenierët brenda 30 ditëve pasi t'i jenë vënë në dispozicion Blerësit nga dërguesi i ngarkesës. Pas skadimit të kësaj periudhe, Shitësi do të ketë të drejtë të faturojë kontenierin(ët) me çmimin aktual.

Neni 14

Modifikimet, ndryshimet e furnizimit

14.1 Modifikimet e inkomporuara përpara dërgimit të furnizimeve.

Pajisjet do të prodhohen në përputhje me konfigurimin e prodhimit aktual të Shitësit për modelin e helikopterit të zgjedhur. Ndryshimet e konfigurimit mund të bëhen në çdo kohë nga Shitësi në pajtim me rregullat e çdo autoriteti kombëtar përkatës.

Për më tepër, Shitësi mund të bëjë modifikime për furnizimet, sipas kërkesave të prodhimit ose projektimit të ri pa miratimin e Blerësit, me kusht që modifikimet të mos ndikojnë ndjeshëm në performancën e helikopterit, çmimin kontraktual ose kohën e dërgimit. Nëse modifikimet ndikojnë

ndjeshëm në performancën e helikopterit, koston dhe kohën e dërgimit të lidhur me të, Shitësi do të konsultohet me Blerësin për të arritur një marrëveshje mbi pasojat ndaj kontratës.

Çdo ndryshim i konfigurimit të kërkuar nga Blerësi do t'i nënshtrohet amendimit të ndërsjellë me shkrim të kësaj kontrate dhe një rregullimi të çmimit total të pajisjeve, pagesave të kërkuara dhe kushteve të dërgimit.

14.2 Modifikimet e vendosura pas dërgimit të furnizimeve

Shitësi do të njoftojë Blerësin për çdo modifikim që Agjencia kompetente Qeveritare e Gatishmërisë për Fluturim Kombëtar ka vendosur për të bërë në helikopterë të të njëjtit tip. Në rast të këtyre modifikimeve, Shitësi do të vërë në dispozicion të Blerësit, brenda një kohe të arsyeshme, me kërkesë dhe shpenzim të këtij të fundit, pjesët e këmbimit të kërkuara për të inkorporuar modifikime të tilla në helikopter dhe pjesët e këmbimit të dërguara më parë.

Për këtë qëllim, Blerësi do të marrë pa kosto shtesë buletine me informacion teknik të lidhura me tipin e helikopterit në këtë kontratë, me kusht që të paktën një helikopter i atij tipit të qëndrojë në shërbim të Blerësit.

Neni 15

Dokumentacioni i përputhshmërisë dhe cilësisë së produktit

Konfirmimi zyrtar që pajisjet kanë përmbushur procedurat e sigurimit të cilësisë, provohet nga lëshimi i dokumenteve të mëposhtme:

Helikopteri(ët) në versionin standard dhe pajisjet e instaluar të misionit:

Një deklaratë e përputhshmërisë ose një certifikatë e përputhshmërisë e lëshuar nga organizata e cilësisë së shitësve për të vërtetuar pajtueshmërinë me kërkesat kontraktuale.

Neni 16

Garancia

16.1 Shitësi garanton që pajisjet e prodhuara dhe të dërguara, përveç motorit (ve) të turbinës dhe pajisjeve avionike MEGHAS, të mos kenë defekte në materiale dhe punëtorë dhe të jenë nën përdorim dhe shërbim normal.

Detyrimi i Shitësit në këtë garanci kufizohet në riparimin ose zëvendësimin, me zgjedhjen e Shitësit, të pjesëve që supozohet të kenë defekte, të cilat i janë kthyer atij dhe në kohën e një zëvendësimi riparimi, është konfirmuar nga Shitësi pas ekspertizës si me defekte. Për të qenë i pranueshëm sipas kësaj garancie, defekti i pretenduar duhet të këtë ndodhur brenda afateve të mëposhtme, siç janë përcaktuar nga Shitësi:

Për helikopterin (ët) në version standard dhe për pajisjet opsionale të instaluar:

- Brenda 500 (pesëqind) orëve fluturimi ose 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve pas dorëzimit të tyre përfundimtar tek vendndodhja e Blerësit, cilado periudhë që skadon e para.

Për pjesët e këmbimit:

- Brenda 1000 (një mijë) orëve fluturimi ose 12 (dymbëdhjetë) muajve nga koha kur janë instaluar në helikopterë ose 24 (njëzet e katër) muaj pas dorëzimit të tyre përfundimtar në vendin e Blerësit, cilado që skadon e para.

Për mjetet:

- Brenda një periudhe prej 24 (njëzet e katër) muajve pas dërgimit nga fabrika e Eurocopterit.

Periudha e garancisë në pjesët e riparuar ose të zëvendësuara është periudha e garancisë që kishte mbetur për pjesën me defekte. Pjesa e hequr për të cilën Shitësi furnizon një pjesë zëvendësimi bëhet pronë e Shitësit.

16.1.2 Sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga zbulimi i ndonjë defekti, Blerësi do t'i japë Shitësit, nëpërmjet një formulari kërkesë garancie, të gjitha hollësitë e pretendimeve dhe arsyet e tyre. Me marrjen e formularit të kërkesës së garancisë,

Shitësi do t'i kthejë Blerësit konfirmimin e kërkesës së garancisë dhe formularin e autorizimit të kthimit të materialit. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e këtyre dy dokumenteve, Blerësi do t'i kthejë Shitësit pjesën që supozohet që të jetë dëmtuar.

16.1.3 Shitësi do të riimburojë kostot e arsyeshme të transportit për pjesët e riparueshme, për të cilat përfitimet e garancisë janë dhënë nga Shitësi. Blerësi do t'i dërgojë Shitësit faturën në fund të vitit korrespondues. Siguracionet, shpenzimet doganore dhe detyrime të tjera, si dhe shpenzimet e shkaktuara nga Blerësi për operacionet e heqjes, riinstalimit dhe rregullimit përsa u përket këtyre pjesëve do të përballohen nga Blerësi.

Për pjesët e kthyera, për të cilat përfitimet e garancisë janë dhënë nga Shitësi, kostoja e brendshme e kthyer e transportit do të përballohet nga Shitësi.

16.1.4 Kjo garanci do të zbatohet vetëm në shkallën që helikopteri dhe pjesë të instaluar në të operohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet në përmbajtje të publikimeve teknike të dhëna nga Shitësi. Përveç kësaj, kjo garanci do të zbatohet vetëm në shkallën që aktivitetet e mirëmbajtjes janë regjistruar, sipas rregullave në regjistrin e duhur të udhëtimit. Regjistri i udhëtimit do të përgatitet për Shitësin nëse kërkohet. Për më tepër, kjo dispozitë do të zbatohet për pjesët e këmbimit vetëm në shkallën kur ato magazinohen dhe instalohen, operohen dhe mirëmbahen siç duhet, në përputhje me udhëzimet e parashtuara në publikimet teknike.

16.1.5 Konsumimi normal i komponentëve si, por jo duke u kufizuar në, shenjat, gomat, tubat e brendshëm, llambat, paketimet dhe pjesë të ngjashme konsumi, si dhe pjesë, lista e çmimeve të të cilave është 50 (pesëdhjetë) euro ose më e ulët, nuk mund të jetë objekt i ndonjë pretendimi sipas kësaj garancie.

16.1.6 Motori (ët) i turbinës, si dhe pajisjet avionike MEGHAS, të instaluar në helikopter mbulohen nga garancia e dhënë nga prodhuesit e këtyre artikujve (Turbomeca dhe Thales), përfitimet e të cilave Shitësi ia cakton Blerësit. Rrjedhimisht, çdo pretendim i mëtejshëm ndaj Shitësit, lidhur me këto artikuj, do të përjashtohet.

Për më tepër, Shitësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi për pajisjet e furnizuara nga Blerësi (BFE).

16.1.7 Përfshirja nga Blerësi, në ndonjë helikopter, të ndonjë modifikimi i cili nuk është rekomanduar ose nuk ka marrë miratimin e mëparshëm nga Shitësi, do të shkaktojë ndërprerjen e garancisë. Për më tepër, kjo garanci nuk do të zbatohet në çdo pjesë ose helikopter që është riparuar ose modifikuar jashtë fabrikës ose qendrës së riparimit të Shitësit.

Garancia do të pushojë së zbatuari në rast të ndonjë defekti të pjesshëm ose të plotë të shkaktuar nga ndonjë pjesë me defekt të pasiguruar nga shitësi.

Garancia do të pushojë së zbatuari për pajisjet të cilat janë vënë përsëri në shërbim pas heqjes nga një helikopter të përfshirë në një aksident, nëse Blerësi nuk mund të provojë që defekti nuk ka ardhur si rezultat i aksidentit.

16.1.8 Kjo garanci i është dhënë Blerësit personalisht dhe nuk mund të jepet nga Blerësi pa miratimin paraprak me shkrim nga Shitësi.

16.1.9 Garancia e përmendur përbën përgjegjësinë e vetme të Shitësit, dhe është në vend të çdo garancie tjetër, dhe është ekskluzive për çdo kompensim. Shitësi nuk do të ketë përgjegjësi për ndonjë incident të dëmtimeve pasuese që rrjedhin nga ndonjë shkelje e garancisë.

Neni 17 Trajnimi

17.1 Të përgjithshme

Shitësi do të sigurojë pa kosto shtesë, trajnime për pilotë dhe teknikë për çdo helikopter të dërguar sipas kushteve të specifikuara në nenet vijuese.

Këto trajnime mund të organizohen nga Shitësi ose nga një ndihmës ose nënkontraktor i miratuar dhe i certifikuar dhe do të kryhen në vendin e dërgimit të shitësit të caktuar jashtë Shqipërisë.

Trajnimi për pilotët do të kryhet maksimumi në kohën kur do të bëhet dërgimi i helikopterit të fundit të parashikuar në kontratë dhe për teknikët 6 (gjashtë) muaj pas dërgimit të helikopterit të fundit të parashikuar në këtë kontratë.

Ky trajnim do të sigurohet vetëm për pilotët profesionistë në drejtimin e helikopterit dhe teknikët e konfirmuar të Blerësit që flasin anglisht rrjedhshëm.

Shitësi rezervon të drejtën të përcaktojë dhe të vendosë një kërkesë aftësish minimale për çdo pilot dhe teknik që do të trajnohet brenda kësaj kontrate dhe do të refuzojë çdo pilot dhe teknik të cilët nuk përmbushin këto kërkesa ose do të sigurojë trajnim shtesë dhe/ose shërbime profesionale përkthimi, të cilat do të paguhen sipas tarifave dhe datave aktuale, siç përshkruhen në listën B, shtojca teknike, volumni I D, shtojca 1.

Klienti do të përballojë shpenzimet për shtyrjen e trajnimit, nëse nuk arrin të dërgojë personelin e tij në datën e rënë dakord me Shitësin, sipas afateve kohore të lartpërmendura.

Nëse Blerësi vendos të mos marrë pjesë tërësisht ose pjesërisht në trajnim, asnjë kredit nuk do të jepet nga Shitësi.

Trajnimi shtesë i kërkuar nga Blerësi do të paguhet me tarifën përkatëse të vendosura nga Shitësi.

Blerësi do të jetë përgjegjës për shpenzimet që lidhen me këto tarifa siç jepen hollësisht në nenin 17.1.1 më poshtë.

17.1.1 Shpenzimet në vijim do të përballohen nga Blerësi për personelin e tij:

- Mbulimi i rreziqeve të shkaktuara gjatë fluturimit ose qëndrimit në tokë nga personeli i tij dhe rreziqet si rrjedhojë e përgjegjësisë civile të këtij personeli.
- Shpenzimet e udhëtimeve nga shteti i Blerësit në vendin e trajnimit dhe në kthim.
- Shpenzimet e jetesës dhe udhëtimit në vendin ku do të bëhet trajnimi.

Çdo kursant i caktuar nga Blerësi për të ndjekur trajnimin do të ketë përvojën e nevojshme dhe kualifikimin e duhur, siç përshkruhet në programin e siguruar nga Shitësi. Blerësi do të jetë përgjegjës për nivelin profesional të kursantëve.

Përveç rasteve të neglizhencës flagrante të Shitësit, Blerësi do të ketë përgjegjësi për humbjen dhe dëmtimet e pronës së Blerësit, ndërsa janë në ambientet e Shitësit.

Informacioni personal i kërkuar nga përfaqësuesit e Blerësit për të mundësuar hyrjen në ndërtesat e Eurocopter do të dërgohet nga Blerësi te Shitësi të paktën 4(katër) javë përpara datave të mbërritjes së tyre.

17.1.2 Trajnimi i pilotëve

EUROCOPTER do të sigurojë trajnim tokësor dhe trajnim alternativ fluturimi për rregullat vizuale të fluturimit, të cilat operojnë sipas programit bazë të vendosur nga departamenti përkatës i trajnimit fluturues të Shitësit në Francë.

Ky trajnim do t'u sigurohet pilotëve të Blerësit që janë profesionistë të fluturimit dhe të rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Shitësi rezervon të drejtën të vendosë një grup kërkesash të aftësive minimale për çdo pilot që do të trajnohet sipas kontratës dhe të refuzojë çdo pilot që nuk plotëson këto kërkesa ose do të sigurojë trajnim shtesë dhe/ose shërbime përkthimi profesional, sipas tarifave dhe datave aktuale, siç përcaktohet në listën B, shtojca teknike, volumni I D, shtojca 1.

Trajnimi teorik dhe trajnimi fluturues alternativ sigurohen pa pagesë për çdo helikopter të blerë dhe përfshin si më poshtë:

- 10 (dhjetë) pilotë për deri 2 (dy) javë kurse tokësore secili.
- 10 (dhjetë) pilotë për deri 10 (dhjetë) orë fluturimi secili dhe 2 (dy) orë testimi.
- 2 (dy) pilotë instruktorë për deri në 6 (gjashtë) orë fluturimi secili.

Trajnimi fluturues do të kryhet në helikopterin (ët) e blerë nga Blerësi pas dorëzimit dhe Kalimit të Pronësisë. Këto fluturime do të kryhen nën përgjegjësinë e pilotit të Shitësit që vepron si kryepilot.

Mbulimi i arsyeshëm i sigurimit nga rreziqet si rrjedhojë e fluturimeve të trajnimit do të përfshihet në politikën e sigurimit të Shitësit. Shitësi do të informojë Blerësin sipas kërkesës së tij për shkallën e këtij mbulimi.

Gjatë trajnimit alternativ të fluturimit, Shitësi do të jetë në ngarkim të nivelit O të mirëmbajtjes operacionale në helikopter.

Çdo pjesë këmbimi e përdorur gjatë fluturimeve të trajnimit dhe që nuk përfshihet në garanci do t'i faturohet Blerësit.

Trajnimi shtesë i kërkuar nga Blerësi do të paguhet sipas tarifave aktuale të vendosura nga Shitësi.

Blerësi do të ngarkohet për shpenzimet e lidhura me këto tarifa, siç përcaktohet me hollësi në nenin 17.1.1 më sipër.

17.1.3 Trajnimi i teknikëve

EUROCOPTER dhe prodhuesi i motorëve do të sigurojnë kurse trajnimi tokësor për teknikët e konfirmuar të Blerësit në departamentin e trajnimit të Shitësit dhe të prodhuesit të motorëve në Francë.

Ky trajnim do të sigurohet vetëm për teknikët e konfirmuar nga Blerësi, të cilët janë të rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Programet dhe datat e tarifave do të bien dakord reciprokisht midis palëve jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara dërgimit të helikopterit të parë.

Shitësi rezervon të drejtën të përcaktojë një grup kërkesash të aftësive minimale për çdo teknik që do të trajnohet, sipas kësaj kontrate dhe do të refuzojë çdo teknik që nuk plotëson këto kërkesa ose do të sigurojë trajnim shtesë dhe/ose shërbime përkthimi profesional, të cilat do të paguhet sipas tarifave dhe datave aktuale, në listën B, shtojca teknike, volumni I D, shtojca 1.

Trajnimi i teknikëve do të përfshijë si më poshtë:

- 5 (pesë) teknikë për deri 4 (katër) javë kurs për korpusin e helikopterit dhe 1 (një) javë kurs për motorin secili.

- 2 (dy) teknikë për deri 4 (katër) javë kurs avionik.

Trajnimi shtesë i kërkuar nga Blerësi do të paguhet me tarifat përkatëse të vendosura nga Shitësi.

Blerësi do të paguajë shpenzimet që lidhen me këto tarifa, siç përcaktohen me hollësi në nenin 17.1.1 më sipër.

Neni 18

Publikimi teknik

18.1 Shitësi do të sigurojë pa kosto shtesë publikimet teknike të mëposhtme në gjuhën angleze:

Një kopje të printuar të:

- Manualit të fluturimit për çdo helikopter;

- Një set buletinesh shërbimi për kontratë;

- Manualin e shërbimit master për kontratë.

Shënim. Manuali i fluturimit dhe manuali i shërbimit master do të jenë në përputhje me përcaktimin e helikopterit të dërguar.

Dokumentet janë siguruar fillimisht në versionin më të fundit të disponueshëm të rishikuar.

Përshtatja e dokumentacionit për shkak të pajisjeve ose instalimeve të reja, sipas specifikave të Blerësit do të sigurohet për dokumentacionin e mirëmbajtjes brenda 4 (katër) muajve pas dërgimit të helikopterit të parë dhe dokumentet identifikuese brenda një kohe të përlllogaritur prej 8 (tetë) deri 9 (nëntë) muaj, por jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj pas dërgimit të helikopterit të parë.

Dokumentet e prodhuesit të motorëve do të dërgohen në Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Shitësi do të japë pa kosto shtesë për sa kohë që helikopteri është në funksionim, manualin e fluturimit, manualin e shërbimit master dhe përditësimet e buletineve të shërbimit.

Në mënyrë që Shitësi të jetë në një pozitë që të plotësojë detyrimet e tij, Blerësi ndërmerr të njoftojë Shitësin për çdo ndryshim qoftë në adresën e Blerësit ose në emrin e pronarit, nëse helikopteri ndërkohë është shitur.

18.2 Dokumentacioni i motorit dhe përditësimet e tij do të varen nga prodhuesi i motorëve.

Dokumentacioni i motorit Turbomeca përditësohet nga Turbomeca pa kosto shtesë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh pas dërgimit të helikopterit të fundit dhe miratimit për përditësimet pas kësaj periudhe.

Neni 19

Përgjegjësia kontraktuale

Në rastin e një faji të provuar ose mospërputhjeje me përgjegjësitë e marra, cilado qoftë arsyeja, përgjegjësia kontraktuale e Shitësit do t'i kufizohet ekskluzivisht dëmit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm. Përgjegjësia kontraktuale e lartpërmendur e Shitësit nuk do të kalojë dhjetë (10%) të vlerës së kontratës.

Blerja e pjesëve nga Blerësi kryhet brenda kuadrit të aktiviteteve profesionale të tij dhe Blerësi bie dakord shprehimisht për kufizimet e përgjegjësisë, siç është përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 20

Dëmet e likuiduara

Nëse Shitësi është në mospërbushje të detyrimeve për arsye të shkaktuara vetëm nga ai dhe si rrjedhim nuk arrin të respektojë datën e specifikuar të dërgimit të helikopterit për atë helikopter në programin e dërgimit, në përputhje me nenin 12.2, Blerësi do të ketë të drejtën e likuidimit të dëmeve dhe jo të një sanksioni për t'u kompensuar nga Shitësi dhe të konsiderohet si borxh ndaj Blerësit të një shume deri në 3% të çmimit të helikopterit të vonuar, objekt i kufizimeve të mëposhtme.

Sasia e dëmeve të likuiduara do të akumulohet në interesin prej 0.5% në muaj të vlerës së helikopterit të vonuar për muaj vonese, duke filluar tre muaj pas datës së dërgimit të planifikuar fillimisht për çdo helikopter të vonuar dhe duke vazhduar akumulimin për çdo muaj të ardhshëm shtyrjeje, që shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për çdo helikopter të vonuar të mos kalojë (3%) të çmimit të helikopterit të vonuar, dhe

- kjo dispozitë përbën kompensimin e vetëm të Blerësit dhe të drejtat për ndërprerjen e dërgimit derisa përqindja maksimale prej 3% e çmimit të kontratës të jetë arritur nga Shitësi si dëme të likuiduara.

Neni 21

Përfundimi i kontratës

21.1 Përfundimi nga Blerësi

Blerësi mund t'i japë fund pjesërisht ose plotësisht kësaj kontrate në rast se Shitësi, në mënyrë të vazhdueshme, nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij pa ndonjë arsye dhe pavarësisht njoftimit të Blerësit me shkrim ndaj Shitësit për të marrë masa të mjaftueshme rregulluese dhe me kusht që këto masa të mos jenë marrë brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh, pas njoftimit të mësipërm të Blerësit. Në këtë rast, do të zbatohen masat e mëposhtme:

a) Blerësi do të autorizohet të dërgojë pajisjet e mbetura, duke mos qenë shkak i mospërbushjes së detyrimeve të tij, dhe do të paguhet për çmimin përkatës.

b) Shitësi do t'i dëmshpërblejë Blerësit shumën e pagesës në këste që i referohet pjesës së paplotësuar të kontratës.

21.2 Përfundimi i kontratës nga Shitësi

Shitësi mund t'i japë fund pjesërisht ose plotësisht kësaj kontrate, në rast se Blerësi, në mënyrë të vazhdueshme, nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij pa ndonjë arsye dhe pavarësisht njoftimit të Shitësit me shkrim ndaj Blerësit për të marrë masa të mjaftueshme rregulluese dhe me kusht që këto masa të mos jenë marrë brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajve, pas njoftimit të mësipërm të Shitësit. Në këtë rast, do të zbatohen masat e mëposhtme:

a) Mallrat e dërgueshme të përfunduara, por ende të padorëzuara dhe të dërguara / zbatuara në datën e marrjes nga Blerësi të këtij njoftimi përfundimi, do të pranohen në zbatim të dispozitave të kësaj kontrate dhe do të dorëzohen nga Shitësi dhe do të paguhen nga Blerësi;

b) Blerësi do të riimburojë Shitësin për të gjitha kostot e vërtetuara (duke përfshirë, por jo kufizuar në lëndën e parë, punën, fletëngarkesën, magazinimin dhe tarifën financiare) shkaktuar nga Shitësi ose që Shitësi nuk mund t'i shmangte (përfshirë dëmshpërblimin e prishjes së kontratës, nëse ka, sipas kontratave ndërmjet Shitësit dhe nënkontraktorëve ose furnizuesve të tij ose nënkontraktorëve të tij të nivelit të dytë ose furnizuesve);

c) Për më tepër, Blerësi do t'i paguaje Shitësit një dëmshpërblim për prishjen e kontratës të barabartë me dhjetë (10%) për qind të çmimit total të kërkueshëm nga Blerësi, sipas shkronjës "b" të këtij neni, si dhe një dëmshpërblim të barabartë me dëmet e pësuar nga Shitësi.

21.3 Përfundimi i kontratës për shkaqe të forcave madhore

Në rast të ndodhjes së një ngjarjeje *Force Majeure*, siç përcaktohet në pikën 12.4.2, që mund të zgjasë më shumë se 6 (gjashtë) muaj të njëpasnjëshëm, palët do të takohen për të vendosur se në cilat kushte ata duan të vazhdojnë kontratën ose në rast se nuk arrijnë një marrëveshje në një periudhë prej një muaji, secila palë ka të drejtën e prishjes së kontratës.

Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit nga pala që synon të prishë kontratën, palët do të gjejnë një zgjidhje.

Neni 22

Gradimi i instrumenteve, shenjave dhe punimet e jashtme

Informacioni në seksionin 22 do t'i sigurohet Shitësit jo më vonë se 1 (një) muaj pas nënshkrimit të kontratës, bazuar në modelet e siguruara nga Shitësi.

22.1 Gradimi i instrumenteve

Instrumentet e fluturimit do të gradohen si më poshtë:

- Indikator i shpejtësisë së ajrit: Nyje ose km/h;
- Matësi i lartësisë : këmbë ose m;
- Kursi i ngjitjes : këmbë/mn ose m/mn;
- Presioni hidraulik : bar;
- Serbatorët e karburantit: kg ose litra ose galonë, ose galonë imperial.

22.2 Shenjat dhe punimet e jashtme dhe tapiceria e brendshme

Nëse nuk deklarohet ndryshe në specifikimet e tipave të helikopterëve korrespondues, shenjat e bëra në brendësi dhe pllakëzat e identifikimit të jashtëm duhet të jenë në gjuhën angleze.

Udhëzimet e hollësishme përsa i përket:

- Skemës së jashtme të bojës së korpusit të helikopterit.
- Ngjyrës së tapicerisë së brendshme – nëse është e nevojshme tapiceri e zgjedhur.

22.3 Emblemat kombëtare dhe regjistrimet

Emblemat dhe regjistrimet kombëtare mund të pikturohen nga Shitësi në korpusin e helikopterit përpara dërgimit. Në rast të tillë, Blerësit do t'i kërkohet të japë udhëzime të hollësishme për skemën dhe brenda të njëjta afateve kohore.

Blerësi do të jetë i përgjegjshëm dhe do të ruajë Shitësin nga ndonjë shkelje e të drejtave të palëve të treta për sigurimin e udhëzimeve, përsa u përket emblemeve, shenjave, shënjimeve ose regjistrimit.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Të gjitha termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje janë rënë dakord dhe miratuar nga të dyja palët.

Palët bien dakord mbi përmbushjen e akteve të mëposhtme:

1. Nënshkrimi i kontratës;

2. Lëshimi i formularit të garancisë së kontratës, siç parashikohet në nenin 11.5.1;
3. Ratifikimi i kontratës nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;
4. Marrja e pagesës së këstit të parë nga Shitësi në llogarinë bankare të tij, siç përcaktohet në nenin 11.2.1.

- Kontrata do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së pagesës së këstit të parë nga Shitësi në llogarinë bankare të Shitësit, siç përcaktohet në nenin 11.2.1 (“Data e hyrjes në fuqi”).

Menjëherë sa të plotësohen në mënyrë të suksesshme të gjitha kushtet e mësipërme, Shitësi do t’i komunikojë me shkrim Blerësit.

Në rast se brenda 6 (gjashtë) muajve pas nënshkrimit të kontratës, kontrata nuk ka hyrë në fuqi, atëherë secila palë ka të drejtën ta konsiderojë kontratën të pavlefshme dhe të anuluar, dhe do t’ia deklarojë këtë me shkrim palës tjetër.

Kjo kontratë përfshirë parathënien, 23 (njëzet e tre) nene dhe shtojcat e tyre Lista A: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe lista B: Shtojca teknike, është bërë në kopje origjinale në gjuhën angleze për çdo palë.

Nënshkruar për dhe nën kujdesin e Blerësit
Shkëlqesia e Tij, Arben Imami, Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë

(firma, vula)

Nënshkruar për dhe nën kujdesin e Shitësit
Zoti Thomas Hein, zv. President i Eurocopter

(firma, vula)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 18.2.2010

Doli nga shtypi më 18.2.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë